



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

BASHKIA KORÇE
NR 2424 PROT
D ATA 03/03/2026



Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ .03.2026

Lënda: THIRRJE E MBLEDHJES JASHTË RRADHE TË KËSHILLIT

KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË

Bulevardi Shën Gjergji, Lgj.12, 7001, Korçë

E nderuar Znj. Kryetare!

Në bazë të nenit 53, pika 3, germa a) të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” kërkoj thirrjen e një mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Korçë për të shqyrtuar materialin:

“Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave dhe përdorimin e fondit të financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë për financimin e projektit “Stimulimi i industrive kreative në qytetin e Korçës”

“Për propozimin e ndryshimit të vkm-së nr. 377, datë 10.7.2025 “Për transferimin e disa pronave në pronësi të Bashkisë Korçë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës”, të ndryshuar”

Shqyrtimi i këtyre materialeve është i nevojshëm për vijimin e procedurave të mëtejshme dhe zbatimin e tij nga ekzekutivi.

Kërkoj miratimin tuaj për thirrjen e kësaj mbledhjeje jashtë rradhe.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Sotirag Fto





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ . ____ . ____

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë **z.Sotirag Filo**

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotirag Filo, se ditën **e premte, datë 13 mars 2026, ora 11⁰⁰** do të zhvillohet mbledhja e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53,pika 4 si dhe bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 , neni 63, neni 64 me rend dite si më poshtë:

- 1- “PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.
- 2- “PER MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “STIMULIMI I INDUSTRIVE KREATIVE NË QYTETIN E KORÇËS”.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti dhe znj. Mirela Qeleshi.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planfikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z.Altin Habip, znj. Ada Përmeti,

- 3- “PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË VKM-SË NR.377 DATË 10.07.2025 “PËR TRANSFERIMIN E DISA PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1532 DATË 19.11.2008 ,TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE , PËR MIRATI,MIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE , QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË , TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR”.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurivve të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti dhe znj. Mirela Qeleshi.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e mërkurë, datë 11.03.2026 , ora 11⁰⁰

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj.Ada Përmeti
z.Petrika Tollkuçi, znj.Mirela Qeleshi, znj.Alketa Zheku **ditën e hënë 11.03.2026, ora 12⁰⁰**

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KORÇË



Bashkia Korçë

Nr 170 Prot
Korçë, më 09, 02, 2026

Nr 1292 Prot
Korçë, më 09, 02, 2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet palëve:

- **Këshillit të Qarkut Korçë** përfaqësuar nga Kryetari **Z. Petrika Tollkuçi**, me adresë: Lagjja 7, Rruga “28 Nëntori”, Korçë,

dhe
- **Bashkisë Korçë** përfaqësuar nga nga Kryetari **Z. Sotiraq Filo**, me adresë: Lagjja 12, Blv “Shën Gjergji”, Nr. 12 Korçë,

Lidhet sot në datë 09/02/2026, kjo marrëveshje bashkëpunimi në vijim të projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*” në qytetin e Korçës duke shprehur reciprokisht vullnetin për bashkëpunim midis tyre, konform legjislacionit në fuqi, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

NENI 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim financimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*” në qytetin e Korçës, me synim stimulimin dhe zhvillimin e industrive kreative në qytet përmes krijimit të kushteve të favorshme për krijuesit, profesionistët dhe sipërmarrjet kreative. Projekti synon të mbështesë talentin lokal, të nxisë sipërmarrjen kreative dhe të kontribuojë në krijimin e vëndeve të reja të punës, duke forcuar imazhin e Korçës si qytet kreativ dhe inovativ.

NENI 2
Objekti i marrëveshjes

1. Objekt i kësaj marrëveshjeje është financimi i projektit në vlerën prej 4 000 000 (*katër milion*) lekë nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë, të cilat do të përdoren për qiranë vjetore të ambienteve që do të përdoren për ushtrimin e aktiviteteve të artizanëve, prodhuesve të rinj kreative.

NENI 3
Baza ligjore

1. Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, referuar nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” nenit 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 139 datë 26.12.2025 “Për projekt buxhetin e Bashkisë Korçë i vitit 2026 dhe PBA 2026- 2028” Vendimit i Këshillit të Qarkut Nr. 50 datë 23.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026”, Vendimit i Këshillit të Qarkut nr. 03 datë 22.01.2026 “Mbi disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2026”, Vendimi i Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit të “Stimulimi i Industriave Kreative” në qytetin e Korçës dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës”, Ligji Nr. 70/2016 “Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. Nr. 43/2022 “Për Zhvillimin e ndërrmarjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

NENI 4
Detyrimet e Këshillit të Qarkut Korçë

1. Këshilli i Qarkut Korçë do të japë kontributin e vet financiar në masën 4 000 000 (*katër milion*) lekë, të cilat do të përdoren për pagesën e qirasë vjetore të ambienteve që do të përdoren për ushtrimin e aktiviteteve të artizanëve, prodhuesve të rinj kreative.
2. Këshilli i Qarkut Korçë ka për detyrë të transferojë për Bashkinë Korçë vlerën e fondit prej 4 000 000 (*katër milionë*) lekë.

NENI 5
Detyrimet e Bashkisë Korçë

1. Bashkia Korçë do të marrë përsipër të lidhë marrëveshje me shoqërinë që do të përzgjidhet për realizimin e projektit “*Stimulimi i Industriave Kreative*” në qytetin e Korçës.
2. Bashkia Korçë do të lidhë kontratat e qirasë për zhvillimin e aktivitetit të projektit duke siguruar ambientet që do vihen në funksion të artizanëve apo prodhuesve të rinj kreative.

3. Bashkia Korçë do të promovojë dhe bëjë marketingun e projektit *“Stimulimi i Industrive Kreative”* si dhe do të pasqyrojë në të gjitha komunikimet e saj kontributin e Këshillit të Qarkut Korçë për këtë projekt, duke përfshirë në shenjat, tabelat në vend, elementet vizuale në materialet promovuese, në komunikimet në mediat sociale si dhe në komunikimet me mediat publike.
4. Bashkia Korçë merr përsipër që të përdorë fondin e dhënë nga Këshilli i Qarkut Korçë vetëm për realizimin e projektit *“Stimulimi i Industrive Kreative”* në qytetin e Korçës. Nëse në fund të zbatimit të projektit rezulton se fondi i dhënë nga Këshilli i Qarkut Korçë nuk është ezauruar i gjithi, pjesa e mbetur do t’i kthehet Këshillit të Qarkut Korçë.
5. Bashkia Korçë merr përsipër që të mbikqyrë dhe ndjekë të gjithë zhvillimin e procedurave dhe zbatimit të projektit.
6. Bashkia Korçë do të informojë Këshillin e Qarkut Korçë, me kërkesë të Këshillit të Qarkut Korçë mbi mbarëvajtjen e zbatimit të këtij projekti,

NENI 6

DETYRIMET E PËRBASHKËTA

1. Palët angazhohen të organizojnë aktivitete të përbashkëta për promovimin e projektit *“Stimulimi i industrive Kreative”* në qytetin e Korçës dhe të zhvillojnë programe bashkëpunimi me artizanet, profesionistët apo prodhuesit e rinj kreativ.
2. Të dyja palët do të sigurojnë mbështetje për realizimin e aktiviteteve dhe eventeve të projektit, duke specifikuar llojin dhe natyrën e mbështetjes që do të ofrojnë.

NENI 7

AFATI I HYRJES NË FUQI TË MARRËVESHJES.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj prej palëve.

NENI 6

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Marrëveshja do të jetë e vlefshme deri në përfundim të projektit dhe kohëzgjatjes së parashikuar për zbatimin e tij.

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do zgjidhet me diskutim dhe mirëkuptim midis palëve.

NENI 10

Dizpozitat e fundit

1. Kjo marrëveshje quhet e vlefshme vetëm pasi të jetë nënshkruar nga palët.
2. Kjo marrëveshje u hartua në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi të njëjtë ligjore.
3. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë marrëveshje, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim dhe firmoset nga të dyja palët.

Konceptoi: A. Gjini

Pranoi: I. Melonashi


Miratoi: A. Dishnica Qeramixhi

PËR

KËSHILLIN E QARKUT KORÇË

KRYETARI

PETRIKA TOLLKUÇI



PËR

BASHKINË KORÇË

KRYETARI

SOTIRAQ FILO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr 50 Datë. 23 /12/2025

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT

PËR VITIN 2026

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2026", të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2026, Vendimit të Këshillit të Qarkut "Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2026-2028 për Këshillin e Qarkut", VKM nr. 673 dt. 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publike", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026 si më poshtë:

Të ardhurat e Këshillit të Qarkut gjithsej 222.8 milion lekë

Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	85.8 milion lekë
	- Të ardhurat vendore	20.4 milion lekë
	- Të ardhurat nga Financimi i huaj	18.5 milion leke
	- Të ardhura të trashëguara nga viti 2024	98.1 milion lekë
	- Transferta e kushtëzuar	

Shpenzimet e Këshillit të Qarkut gjithsej 222.8 milion lekë

Nga kjo	Funksionet e veta	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	43.3 milion lekë
	- Për shpërblimin e anëtarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	1.5 milion lekë
	- Për investime nga Këshilli i Qarkut	122.5 milion lekë
	- Shpenzime korrente për realizimin e projekteve të ndryshme të planifikuara	38.1 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Korçë për qendrën Infopoint	3 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Kolonjë për pajisje për qendrën Infopoint	1.2 milion lekë
	- Kontribut bashkia Korçë për vazhdimin e Rezidencës Artistike	2 milion lekë
	- Aktivitete kulturore lokale në bashkëpunim me Bashkitë	3 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Korçë për projektin e artizanatit	4 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Pogradec për pajisjen me kondicionerë të Muzeut Historik	0.4 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Kolonjë për projekt studimin e Muzeut të Sazeve në Leskovik	1.5 milion lekë
	- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë	0.2 milion lekë
	- Projekti STEP	0.1 milion lekë
	- Për fond rezervë	2 milion lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇE
NR 2391 PROT
DATA 06/03/2026



BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

RELACION

“PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË VKM-SË NR. 377, datë 10.7.2025 “PËR TRANSFERIMIN E DISA PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1532, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR”

Me VKM-në nr.377 datë 10.07.2025 *“Për transferimin e disa pronave te Bashkisë Korçë për disa ndryshime në vendimin e këshillit të ministrave nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” e ndryshuar, Bashkisë Korçë i janë transferuar në pronësi pasuritë si më poshtë:*

- Pasuria nr.4/6 zk.8564
- Pasuria nr.4/1246 zk.8561
- Pasuria nr.213/2 zk.2631
- Pasuria nr.510/44 zk.1473
- Pasuria nr.7/984+N1 zk.8562

Në pikën 4 të VKM-së përcaktohet se:

- Bashkisë Korçë i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pronave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Bazuar në nenet 23 pika 14 dhe nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,ligjit nr.8744 datë 22.01.2001” *Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”i ndryshuar, kërkojmë, miratimin e propozimit për ndryshimin e VKM-së nr. 377, datë 10.7.2025 “Për transferimin e disa pronave në pronësi të bashkisë korçë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës” të ndryshuar” për heqjen e kufizimit për ndalimin e tjetërsimit të pronave përcaktuara në këtë VKM.*

Ky ndryshim kërkohet nga fakti se ky kufizim pengon administrimin dhe përdorimin efektiv të tyre nga njësi e vetëqeverisjes vendore me qëllim mundësimin e përdorimit ose tjetërsimit të tyre në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të mëtejshëm të komunitetit.

Kryesisht prona me nr.rendor 966 referuar pasurisë nr.4/1246 zk.8561 “trual” me sipërfaqe totale 2000m² si dhe ajo me nr.rendor 968 referuar pasurisë nr. 213/2 zk.2631”shesh” me sipërfaqe totale 15218 m² parashikohet të përdoren për realizimin e politikave sociale dhe publike, përfshirë vënien e tyre në dispozicion të palëve të treta për qëllime strehimi apo për administrim nga enti i banesave, lind nevoja për rishikimin e këtij propozimi për heqjen e kufizimit.

Për sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak, miratimin e propozimit për **ndryshimin e VKM-së nr. 377, datë 10.7.2025 “Për transferimin e disa pronave në pronësi të bashkisë korçë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës”, të ndryshuar”** për heqjen e kufizimit për ndalimin e tjetërsimit të pasurive me numër rendor si më poshtë:

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronave	Lloji i transferimit të pronave
966, 968	Strehim dhe ndërtim banesa sociale	Në pronësi
967	Administratë	Në pronësi
969	Zhvillim ekonomik	Në pronësi

Drejtore e Përgjithshme
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi



KRYETARI I BASHKISË

Sotirag FLO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/VENDIM

Nr _____, datë _____.2026

“PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË VKM-SË NR. 377, datë 10.7.2025 “PËR TRANSFERIMIN E DISA PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1532, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore bazuar në nenin nenet 23 pika 14 dhe nenin 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr.8744 datë 22.01.2001” Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të propozojë ndryshimin e VKM-së nr. 377, datë 10.7.2025 “Për transferimin e disa pronave në pronësi të bashkisë korçë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës”, të ndryshuar për heqjen e kufizimit për ndalimin e tjetërsimit të pronave përcaktuar në këtë VKM.
2. Të propozojë heqjen e kufizimit, për ndalimin e tjetërsimit të pasurive me numër rendor si më poshtë:

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronave	Lloji i transferimit të pronave
966, 968	Strehim dhe ndërtim banesa sociale	Në pronësi
967	Administratë	Në pronësi
969	Zhvillim ekonomik	Në pronësi

3. Qëllimi i këtij ndryshimi është për mundësimin e përdorimit ose tjetërsimit të tyre në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të mëtejshëm.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore .

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miraturar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

K R Y E T A R

ANA VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr _____, datë _____.2026

“PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË VKM-SË NR. 377, datë 10.7.2025 “PËR TRANSFERIMIN E DISA PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1532, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore bazuar në nenin nenet 23 pika 14 dhe nenin 54 gërma të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr.8744 datë 22.01.2001” Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”i ndryshuar si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të propozojë ndryshimin e VKM-së nr. 377, datë 10.7.2025 “Për transferimin e disa pronave në pronësi të bashkisë korçë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës”, të ndryshuar për heqjen e kufizimit për ndalimin e tjetërsimit të pronave përcaktuar në këtë VKM.
2. Të propozojë heqjen e kufizimit, për ndalimin e tjetërsimit të pasurive me numër rendor si më poshtë:

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronave	Lloji i transferimit të pronave
966, 968	Strehim dhe ndërtim banesa sociale	Në pronësi
967	Administratë	Në pronësi
969	Zhvillim ekonomik	Në pronësi

3. Qëllimi i këtij ndryshimi është për mundësimin e përdorimit ose tjetërsimit të tyre në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të mëtejshëm.

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore .

5.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miraturar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

K R Y E T A R

ANA VERUSHI